a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

21. Konvertimi në valutë të vetme

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht te ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
 - b) garanci bankare;
 - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me fazë;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë:

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit.
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

LOTI I: "BLERJE MATERIALE PËR "BUJQËSI MJEDIS – PERMAKULTURË NË KOPSHTIN E SHKOLLËS"

Nr.	Artikulli	Specifikimet teknike	Njësia
1	Depozitë uji	Depozita e ujit te jete zinkuar te kete karakteristika e meposhtme, masa te jete 80x64x135xcm- me vendosje horizontale-Kapaciteti depozitës të jetë 500 lira ujë.	copë
2	Fidanë perimesh.	Fidanët e perimeve të jenë fidanë të mirë dhe të shëndetshëm me ngjyrë jeshile në të erët. Ato të jenë të prodhuara në bikerina me torfë të posaçme. Fidanët duhet të jenë sipas kërkesave të mëposhtme: - lartësia e fidanit mbi 10cm – 20 cm. - të jenë të paisura me Çertifikatë fito-snitare dhe Etiketë nga E.K.F.F.- të jetë përcaktuar kultivari. - Fidanët të jenë të këtyre specieve: - Domate, - Specca, - Trangull, - Patëllxhan dhe Kungull gjelle. (mendojmë 20 rrënjë për çdo specie).	rrenjë
3	Bimë aromatike.	Fidanët e bimëve aromatike duhet të jenë të prodhuara në ambiente të posaçme, mjedise të mbrojtura dhe të kenë cilësitë e mëposhtme: Fidanë të prodhuar në vazo me diametër 13 cm. të jenë bimë të shëndetshme me gjatësi mbi 10 cm në çdo vazo të ketë më shumë se 2 bimë. Ndërsa rozmarina një bimë për vazo. Të sigurohen fidanë nga këto bimë aromatike: ROZMARINA	rrenjë

		(rosmarinus officinalis), SHEREBELA (salvia officinalis), RIGONI (origanum vulgare), BORZILOKU (ocimum basilicum), MENTA (mentha), KAMOMILI (matricaria chamomilla) dhe, LAVANDA (lavandula), (mendojmë nga 10 rrënjë për specie).	
4	Bimë bishtajore.	Fidanët e bimëve aromatike duhet të jenë të prodhuara në ambiente të posaçme, mjedise të mbrojtura dhe të kenë cilësitë e mëposhtme: Fidanë të prodhuar në vazo me diametër 13 cm me torfë të gatshme. Të jenë bimë të shëndetshme me gjatësi mbi 10 cm në çdo vazo të ketë më shumë se 1 bimë. Fidanët të jenë si më poshtë: - Fasule bishtajë, me bishtaja ngjyrë jeshile për konsum të freskët, të njoma. - Fasule bishtajë me bishtaja ngjyrë të bardhë për konsum të freskët, të njoma- Bizele. - Fidanë në vazo të jenë me gjatësi mbi 20 cm- Fidanët të jenë të shoqëruar me Çertifikatë fito – sanitare.	rrënjë
5	Pemë frutore 3 vjeçare rrënjë.	Fidanët e pemëve 3 (tre) vjeçare të jenë të shoqëruara me: - Etiketë, - Çertifikatë Fito – sanitare. Fidanët të jenë në këto standarte: - të jenë në vazo plastike me “bukë dheu”, - Të shartuara me lartësi fidani 1.5 – 2 m, - me kurorë të formuar, - trashësia e fidanit 5 cm mbi pikën e shartimit $\varnothing = 20 - 30$ mm. - Speciet e pemëve frutore të sigurohen në përshtatje me kushtet klimatiko – tokësore. - Për zonën e Tiranës (zona Fushore e bregdetare) të sigurohen: fidanë molle, dardhe, portokalli, limoni e mandarine nga dy rrënjë sejcila. (në “bukë dheu” në vazo e të shartuara. Të dhënat e fidanëve i cilësuan më sipër).	rrënjë
6	Pemë për mbrojtje nga era.	Fidanët e pemëve për mbrojtje nga era të jenë: Fidanët të jenë të moshës të mbi 3 vjeçare – Të jenë të prodhuara në vazo PVC 10 - 15 litra me bukë dheu ose humos i parapërgaditur. - Fidanët të jenë të specieve Ligustra 4 vazo, Oleandri 2 vazo, Pisha Tuja 2 vazo dhe Lelanda 2 vazo. - Të shoqëruara Çertifikatë Fito – sanitare. - Trashësia e fidanit 5 cm mbi sipërfaqen e vazos të jetë $\varnothing \geq 15$ m.	rrënjë
7	Kosh për kompostimin e mbeturinave të bimëve. 1m ³	Kosh për kompostimin e mbeturinave të bimëve. Vëllimi: 1m ³ Materiali i koshit: Plastik	copë
8	Guralecë zhavorri	Guralecë zhavorri për shtrim rrugicash me përmasa, diametër $\varnothing = 10 - 20$ mm	m ³
9	Tub uji kryesor.	Tubi i ujit për marjen e tij në burim duhet të jetë material PVC dhe me diametër $\varnothing 32$ mm; PE - PN, 6 atm.	ml
10	Tub uji për ujitje.	Tubi i ujit I cili përdoret për shpërndarjen e ujit sipas rrjeshtave në çdo bimë të cilin e siguron nga tubi kryesor duhet të jetë material PVC dhe me diametër $\varnothing 20$ mm; PN, 6 atm.	ml

11	Paisje për ujitje.	Saraçineskë kryesore. Për realizimin e sistemit të ujitjes me pika nevojitet një saraçineskë zingato kryesore që vihet aty ku meret uji për ujitje e cila të ketë diametër $\varnothing = 32$ mm. Saraçineska në rrjesht. Realizimi i sistemit të ujitjes për çdo bimë kërkon saraçineska zingato për lëshimin e ujit sipas rrjeshtave, dhe këto saraçineska duhet të kenë diametër $\varnothing = 20$ mm. Sprucator. (Materiale didaktike) Po kështu për finalizimin e shërbimit të ujitjes me pika nevojiten edhe lëshuesit fundor të ujit sprucator ose bek. Numri i tyre duhet të jetë sa numri i bimëve të mbjella.	cope
12	Qese me torfë /humus.	Qeset me torfë ose humos janë të parapërgaditura me kapacitet 30 litra (70 X 50 cm.)	cope
13	Lopatë për bimë me lule.	Lopatat për shërbime për bimët, lule e perime të kopështit duhet të jenë të përmasave më të vogla se të zakonshmet me përmasa (20 x 9.5 x 39 cm), Material PP.	cope
14	Lopatë pune.	Lopatat për shërbime në kopësht si punime duhet të jenë të përmasave (71 x 16.5 x 14.5 cm), Material PP.	cope
15	Cfurk.	Sfurqet duhet të jenë të tillë që të realizojnë shërbimet si lëvisje mbeturinash të bimëve apo plehit de të këna dimensione (31 x 23.5 x 9.5 cm), Material PP.	cope
16	Kova.	Kovat të jenë cilësore me material PVC me kapacitet 5 - 7 litra.	cope
17	Çizme për fëmijë,	Të jenë cilësore, me material PVC ngjyrë blu nr 29 (4 palë), 31 (4 palë), 33 (2 palë)	pale
18	Kanë, Vadtisë me hinkë (shoshë).	Të sigurohen vadtisë të perimeve, bimëve me hinkë (shoshë) me kapacitet 7 - 10 litra.	cope
19	Gardhi i kopështit,	Gardhi i kopështit duhet të jenë material druri të thate me ngjyrë natyrale me diametër 7-10 cm, me gjatësi 1 m, dimensioned e gardhit 180 X 80 cm	cope
20	Sanë e balosur (ballo).	Ballot e sanë së jonxhës të kenë këto dimensione 70 X 46 X 36 cm.	cope
21	Pleh organik i kalbur mirë. (5kv)	Për të siguruar bime e pemë të shëndetshme është e nevojshme të përdoret plehu organik para mbjelljes ose gjatë mbjelljes. Plehu të jetë pleh gjedhi i kalbur mirë.	kv
22	Plehra kimike.	Plehrat kimike duhet të jenë me përmbajtje të tre elementëve kryesorë, azot, fosfor e potas si dhe mikroelementë.	kv

LOTI II: “BLERJE MATERIALE PËR “ART DHE ZEJE”

Nr.	Emërtimi I arti Zeje - Arte Tradicionale	Specifikimet teknike	Njësia
1	Bobina e fijeve të peshkut	Bobina 250gr, fije lino,	kg
2	Bobina me fije pambuku	Bobina 250gr, fije Pambuku, nr.50	kg
3	Fije akriliku	artizan, 1 turre 100 gr/ fije akriliku per shtiza	kg
4	Shtiza	artizan, / spear-loom (artizan shtize tezgjah)	copë
5	Kornizë druri për tezgjah	artizan, / spear-loom (artizan shtize tezgjah 30 cm me 49 cm) druri	copë
6	Gërshërë	artizan/tailoring base/ rrobaqepsie)	copë

7	Ngjitës	Bobina silikoni shoqeruar me ngrohës për perpunimin e silikonit mekanik	copë
8	Copa për çanta në metra	artizan/tailoring base/ rrobaqepsie) dendësia 200gr/m2	copë
9	Rrotulla letre të bardhë	Leter e bardhë, tabak	copë
10	Gjilpëra dore	Plastike dhe metalike, për përdorim individual për femije	copë
11	Tezgjah	Te vogla për trajnime individuale përmasa 30x40 cm/ kompesate e presuar që mban brenda kreherin ngjeshës dhe gjilpërë druri për fijen e thurjes	copë
12	Fije pambuku	Nr.50 me bobina të pershtatshme për tezgjah/ bobina 250 gr.	kg
13	Copa prej linoje në metra	Lino me 70 % pambuk/ dendësia 200 gr/m2	copë
14	Tavoline qëndisje	Cope e printuar dizajn përkatës për qëndisje// cope lino e printuar me bojra eco product	copë
15	Fjongo me ngjyra të ndryshme	Fjongo me gjerësi 3 cm pelhure sintetike// artizan// embroiderer	metër
16	Korniza për qëndisje dhe piktura	Gjergjef druri i pershtatur për të mirembajtur copat që punohen	copë
17	Dru specifik	Binar bredhi i pa planuar 7.5x7.5 cm x3m/ Binar pishe i planuar 6.5x12.5 cm x 3.6m	copë
18	Kallupe	Kallupe dru pishe, bredhi	copë
19	Sharrë me zinxhir	Motosharre me zinxhir 1800w, me lame 40cm	copë
20	Dalta	Dalte druri e drejte, 25 mm	copë
21	Letër zumpare	Rrjete zmerile grit, 180, 5pc, 280x93 mm	copë
22	Bojë vaji	Bojë vaji me shkelqim, metal/dru/0.75 lit. mbulon 10 m2/liter.	copë
23	Llak	Llak i përdorshëm për instrumenta	copë
24	Vegla të tjera për punën	Morsa shtrenguese//sharre hekuri e vogël, sharre druri dore 18", çelik, //sopate dore 1.5 kg, çelik 80 x 20 cm //Sqepar me doreze druri 450 gr //Pincë universale krom-0 vanadium 160 mm// Set me kaçavidë FX tools, 6 cope //çekiç për karpantierë, çelik, doreze druri, 300 gram//Set me lima çelik 6 copë.	copë

	Pikturë-Art figurativ		
25	Bojër vaji	Bojë vaji me tubeta ose ekuivalent me gramatura të ndryshme, pigmente me perzierje vaj lini, minimum 25 ml, 6 cope	set
26	Lapsa pastel	Bojër dhjami vajore/dyloze, trashësia minimum 6mm, seti =24 cope	set
27	Leter vizatimi	Pako me 24 flete diseno, minimumi 220 miligram	pako
28	Telajo	Kornize druri, e mbështjelle me kanavace, përmasa 30cm x40 cm (druri 20mm x 40mm)	copë
29	Bojër uji/ 15 pc	ngjyra me tubeta të tretshme në ujë, sti minimumi 12 cope	pako
30	Lapsa me ngjyra të tretshme në ujë /15 pc	Akuarele në formë lapsi, minimum 12 cope për set	set
31	Bojë akriliku	me tubeta minimum 12 copë	set
32	Tavaloz	Material druri që vendoset në parakrahë nga nxënësit për të perzier bojrat për pikturën, ovale, dimensionimi minimum 20cm x 30 cm. Ideal për perzierjen e bojrave gjatë pikturimit.	copë
33	Tavaloz	Material plastik që vendoset në parakrahë nga nxënësit për të perzier bojrat për pikturën, dimensionimi minimum 20cm x 30 cm. Ideal për perzierjen e bojrave gjatë pikturimit.	copë

34	Penela te dimensioneve te ndryshme	Set penela boje, 24 cope/set	set
35	Kavalete	Kavalete tavoline te vogla qe vendosen mbi tavolina.	copë
36	Gome	Gome e bute	copë
37	Set lapsa grafike	perzierje grafiti me pluhur argjili me nr. te ndryshem, minimumi 6 cope	pako
38	Lapsa karboni	Perzierje qymyri e grafiti	copë
39	Plasteline	Plasteline me kuti, minimumi 500 gram	copë
40	Argjile	Balte minerale-argjile ngjyre gri	copë
41	Vaj lini	200 ml, per tretjen e bojerave te vajit	kg

TEATËR

PAKETA 1- Mosha 8-10 vjec

42	Grim per personazhet e teatrit	Aquacolor me 3 nuanca	Copë
		Penela minimum 3	Copë
		Eye Shadow e zeze	Copë
		Eye Shadow Glitter	Copë
		Manual per Grim per moshat 8-10 vjec	Copë

Totali i paketës

Pakete

PAKETA 2 - Mosha 10-13 vjec

43	Grim per personazhet e teatrit	Aqua Color e kuqe	Copë
		Aqua color e zeze	Copë
		Aqua Color e bardhe	Copë
		Penel, minimumi 3	Copë
		HD/ Blood (gjak artificial i cili perdoret per te krijuar efektin e gjakut)	Copë

Totali i paketës

Pakete

PAKETA 3 - Mosha 14-18 vjec

44	Grim per personazhet e teatrit	Liquid latex	Copë
		Aqua color hair mascara	Copë
		fresh scratch	Copë
		penel	Copë

Totali i paketës

Pakete

	Kor		
45	Fustan per vajza, per korin	Material zhars ose ekuivalent; perdoret material i lehte, me fije medafshi, ose ekuivalent, qe derdhet, me permasa sipas kerkesave te AK	Copë
46	Pantallona e kemishe per djem per korin	Material doku, ose ekuivalent i bute, kambrik ose ekuivalent, me kopsa, perdoret dok i holle, ose ekuivalent dhe i bute per pantallonat dhe puclin e holle ose ekuivalent per kemishat	Copë/ komplet
47	Kepuce te zeza per korin vajza	Lekure e bute, ose ekuivalent me material te lehte	palë
48	Kepuce te zeza per korin djem	Lekure e bute, ose ekuivalent, elastik dhe lidhese, me material te lehte.	palë

	Muzikë – Vegla muzikore		
49	Kitare klasike	Pjesa e sipërme: Bredh, Baack@Anet: Meranti (Shorea macrophyllia), qafa: Nato, Derrase: Palisander (Dalbergia latifolia), Ura: Palisander (Dalbergia latifolia), Gjeresia e arres: 52 mm, Thellesia e trupit: 43-100 mm, 650 mm (25,59"), Ngjyra: Natyrale me shkelqim te larte	copë

50	Metronom digjital	24 variacione rrahjesh per praktikimin e rrahjeve te thjeshta ose komplekse, 9 Ritme, Prekni butonin tempo per te rregulluar shpejt tempin ose per te analizuar ritmin e kenges, Ekran i madh LCD me shume informacione dhe metronom me rezolucion te larte plus 2 LED, Funkzioni i zerit: Dalja e gjysmetoneve nepermjet, i vogel, i lehte, i dobishem dhe i qendrueshem, dizajne shume i sheshte per shkak te baterise se litiumit CR2302, Lidhja per nje kufje stereo, funksioni i fikjes automatike", kapese per stenden e muzikes dhe foleja per nje monedhe... Gama e ritmit 30-250 bpm	copë
51	Sintonizues elektronik	Modalitet kromatike dhe strobe plus 109-LED, Ekran per performancen e Akordimit Ultimate	copë
52	Daulle (Perkusion)	Instrument Muzikor me goditje per te gjitha kategorite e niveleve	copë
53	Tela per kitare klasike (me voltazh te larte)	6 cope tela per kitare klasike, 4 perberje bronzi, 2 me perberje Metal Bronzi	Set
54	Set celesash per kitare	Model AE - 016 JP	set

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:****LOTI I: “BLERJE MATERIALE PËR “BUJQËSI MJEDIS – PERMAKULTURË NË KOPSHTIN E SHKOLLËS”**

Nr.	Emërtimi	Specifikime Teknike	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Depozitë uji	Depozita e ujit te jete zinkuar te kete karakteristikat e meposhtme, masa te jete 80x64x135xcm- me vendosje horizontale-Kapaciteti depozitës të jetë 500 lira ujë.	copë	22	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
2	Fidanë perimesh.	Fidanët e perimeve të jenë fidanë të mirë dhe të shëndetshëm me ngjyrë jeshile në të erët. Ato të jenë të prodhuara në bikerina me torfë të posaçme. Fidanët duhet të jenë sipas kërkesave të mëposhtme: - lartësia e fidanit mbi 10cm – 20 cm. - të jenë të paisura me Çertifikatë fito-snitare dhe Etiketë nga E.K.F.F.- të jetë përcaktuar kultivari. - Fidanët të jenë të këtyre specieve: - Domate, - Specat, - Trangu, - Patëllxhan dhe Kungull gjelle. (mendojmë 20 rrënjë për çdo specie).	rrënjë	1225	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
3	Bimë aromatike.	Fidanët e bimëve aromatike duhet të jenë të prodhuara në ambiente të posaçme, mjedise të mbrojtura dhe të kenë cilësitë e mëposhtme: Fidanë të prodhuar në vazo me diametër 13 cm. të jenë bimë të shëndetshme me gjatësi mbi 10 cm në çdo vazo të ketë më shumë se 2 bimë. Ndërsa rozmarina një bimë për vazo. Të sigurohen fidanë nga këto bimë aromatike: ROZMARINA (rosmarinus officinalis), SHEREBELA (salvia officinalis), RIGONI	rrënjë	780	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

		(origanum vulgaris), BORZILOKU (ocimum basilicum), MENTA (menthe), KAMOMILI (matricaria chamomilla) dhe, LAVANDA (lavandula), (mendojmë nga 10 rrënjë për specie).				
4	Bimë bishtajore.	Fidanët e bimëve aromatike duhet të jenë të prodhuara në ambiente të posaçme, mjedise të mbrojtura dhe të kenë cilësitë e mëposhtme: Fidanë të prodhuar në vazo me diametër 13 cm me torfë të gatshme. Të jenë bimë të shëndetshme me gjatësi mbi 10 cm në çdo vazo të ketë më shumë se 1 bimë. Fidanët të jenë si më poshtë: - Fasule bishtajë, me bishtaja ngjyrë jeshile për konsum të freskët, të njoma. - Fasule bishtajë me bishtaja ngjyrë të bardhë për konsum të freskët, të njoma- Bizele. - Fidani në vazo të jenë me gjatësi mbi 20 cm- Fidanët të jenë të shoqëruar me Çertifikatë fito – sanitare.	rrënjë	327	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
5	Pemë frutore 3 vjeçare rrënjë.	Fidanët e pëmëve 3 (tre) vjeçare të jenë të shoqëruara me: - Etiketë, - Çertifikatë Fito – sanitare. Fidanët të jenë në këto standarte: - të jenë në vazo plastike me “bukë dheu”, - Të shartuara me lartësi fidani 1.5 – 2 m, - me kurorë të formuar, - trashësia e fidanit 5 cm mbi pikën e shartimit Ø = 20 – 30 mm. - Speciet e pemëve frutore të sigurohen në përshtatje me kushtet klimatiko – tokësore. - Për zonën e Tiranës (zona Fushore e bregdetare) të sigurohen: fidanë molle, dardhe, portokalli, limoni e mandarine nga dy rrënjë sejcila. (në “bukë dheu” në vazo e të shartuara. Të dhënat e fidanëve i cilësuan më sipër).	rrënjë	163	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

6	Pemë për mbrojtje nga era.	Fidanët e pemëve për mbrojtje nga era të jenë: Fidanët të jenë të moshës të mbi 3 vjeçare – Të jenë të prodhuara në vazo PVC 10 - 15 litra me bukë dhe ose humos i parapërgaditur. - Fidanët të jenë të specieve Ligustra 4 vazo, Oleandri 2 vazo, Pisha Tuja 2 vazo dhe Lelanda 2 vazo. - Të shoqëruara Çertifikatë Fito – sanitare. - Trashësia e fidanit 5 cm mbi sipërfaqen e vazos të jetë $\varnothing \geq 15$ m.	rrenjë	141	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
7	Kosh për komposti min e mbeturinave të bimëve. 1m ³	Kosh për kompostimin e mbeturinave të bimëve. Vëllimi: 1m ³ Materiali i koshit: Plastik	copë	26	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
8	Guralecë zhavorri	Guralecë zhavorri për shtrim rrugicash me përmasa, diametër $\varnothing = 10 - 20$ mm	m ³	29	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
9	Tubi uji kryesor.	Tubi i ujit për marjen e tij në burim duhet të jetë material PVC dhe me diametër $\varnothing 32$ mm; PE - PN, 6 atm.	ml	208		12 muaj marrëveshje kuadër
10	Tubi uji për ujitje.	Tubi i ujit I cili përdoret për shpërndarjen e ujit sipas rrjeshtave në çdo bimë të cilin e siguron nga tubi kryesor duhet të jetë material PVC dhe me diametër $\varnothing 20$ mm; PN, 6 atm.	ml	348	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
11	Paisje për ujitje.	Saraçineskë kryesore. Për realizimin e sistemit të ujitjes me pika nevojitet një saraçineskë zingato kryesore që vihet aty ku meret uji për ujitje e cila të ketë diametër $\varnothing = 32$ mm. Saraçineska në rrjesht. Realizimi i sistemit të ujitjes për çdo bimë kërkon saraçineska zingato për lëshimin e ujit sipas rrjeshtave, dhe këto saraçineska duhet të kenë diametër $\varnothing = 20$ mm. Sprucator. (Materiale didaktike) Po kështu për finalizimin e shërbimit të ujitjes me pika nevojiten edhe lëshuesit fundor të ujit sprucator ose bek. Numri i tyre duhet të jetë sa numri i bimëve të mbjella.	cope	24	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

12	Qese me torfë /humus.	Qeset me torfë ose humos janë të parapërgaditura me kapacitet 30 litra (70 X 50 cm.)	cope	226	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
13	Lopatë për bimë me lule.	Lopatat për shërbime për bimët, lule e perime të kopështit duhet të jenë të përmasave më të vogla se të zakonshmet me përmasa (20 x 9.5 x 39 cm), Material PP.	cope	161	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
14	Lopatë pune.	Lopatat për shërbime në kopësht si punime duhet të jenë të përmasave (71 x 16.5 x 14.5 cm), Material PP.	cope	51	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
15	Cfurk.	Sfurqet duhet të jenë të tillë që të realizojnë shërbimet si lëvisje mbeturinash të bimëve apo plehit de të këna dimensione (31 x 23.5 x 9.5 cm), Material PP.	cope	63	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
16	Kova.	Kovat të jenë cilësore me material PVC me kapacitet 5 - 7 litra.	cope	192	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
17	Çizme për fëmijë,	Të jenë cilësore, me material PVC ngjyrë blu nr 29 (4 palë), 31 (4 palë), 33 (2 palë)	pale	225	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
18	Kanë, Vadtëse me hinkë (shoshë).	Të sigurohen vadtëse të perimeve, bimëve me hinkë (shoshë) me kapacitet 7 - 10 litra.	cope	67	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
19	Gardhi i kopështit,	gardhi i kopështit duhet të jenë material druri të thate me ngjyrë nayrale me diametër 7-10 cm, me gjatësi 1 m, dimensioned e gardhit 180 X 80 cm	cope	100	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
20	Sanë e balosur (ballo).	Ballot e sanë së jonxhës të këna këto dimensione 70 X 46 X36 cm.	cope	39	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
21	Pleh organik i kalbur mirë. (5kv)	Për të siguruar bime e pemë të shëndetshme është e nevojshme të përdoret plehu organik para mbjelljes ose gjatë mbjelljes. Plehu të jetë pleh gjedhi i kalbur mirë.	kv	68	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
22	Plehra kimike.	Plehrat kimike duhet të jenë me përmbajtje të tre elementëve kryesorë, azot, fosfor e potas si dhe mikroelementë.	kv	26	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

Vendi i dorëzimit të mallit: Sipas Aneksit Nr. 1

Afatet e lëvrimit: Kohëzgjatja - afati i lëvrimit të mallit është 40 (dyzet) ditë nga data e nënshkrimit të mini-kontratës përkatëse

LOTI II: “BLERJE MATERIALE PËR “ART DHE ZEJE”

Nr.	Emërtimi	Specifikime Teknike	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periodha e dorëzimit
	Zeje - Arte Tradicionale					
1	Bobina e fijeve të peshkut	Bobina 250gr, fije lino,	kg	218	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
2	Bobina me fije pambuku	Bobina 250gr, fije Pambuku, nr.50	kg	261	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
3	Fije akriliku	artizan, 1 turre 100 gr/ fije akriliku per shtiza	kg	395	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
4	Shtiza	artizan, / spear-loom (artizan shtize tezgjah)	copë	198	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
5	Kornizë druri për tezgjah	artizan, / spear-loom (artizan shtize tezgjah 30 cm me 49 cm) druri	copë	81	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
6	Gërshërë	artizan/tailoring base/ rrobaqepsie)	copë	211	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
